



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 7.6.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N/204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Bilall Sherifi, Nezir Çoçaj, Igor Simiq, Shkumbin Demaliaj.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Bilall Sherifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Rabije Hyseni dhe Fitore Sopjani, praktikante, Zyra për Marrëdhënie me Publikun; Besiana Bajrami, LO; Ediar Krasniqi, Albert Krasniqi dhe Artan Murati, KDI; Kosovare Gashi, Radio Kosova; Nikola Dakviç, Shefki Kastrati- NDI; Shaban Murturi- EUO/EUSR dhe Sanije Berisha, OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 19.4 dhe 24.4.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i grupit punues për Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë;
4. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr.06/L-009 për Ndërmjetësim;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i grupit punues për Projekt-Kodin nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur;

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale;
7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje;
8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Draft-Rregulloren e Kuvendit;
9. Të ndryshme.

Shkumbin Demaliaj, propozoi që pika e pestë e rendit të ditës të zhvendoset në pikën e tretë të rendit të ditës, anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës miratohet me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 19.4 dhe 24.4.2018

Kryetarja konstatoi se u miratuan procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më datë 19.4. dhe 24.4.2018.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të grupit punues për Projekt-Kodin nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur

Shkumbin Demaliaj, tha se grupi punues e ka përfunduar punën në amendamentimin e Projekt-Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur, gjithmonë në bashkëpunim me mekanizma të shumtë, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë dhe organizatat ndërkombëtare, si UNICEF, OSBE, etj. Po ashtu, përmendi edhe gjykatat, prokuroritë, qendrat e rehabilitimit dhe të korrektimit, duke thënë se kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për Projekt-kodin.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetarja konstatoi se komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë

Rekomandim:

- I. Miratohet Raporti me amendamente për Projekt-Kodin nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur;
- II. Projekt-Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim, sipas kompetencës në komisionet kryesore;
- III. Amendamentet e miratuara dhe të papërkrahura nga komisioni, janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i grupit punues për Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë

Kryetarja paraqiti para komisionit, raportin me amendamente të grupit punues për Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë dhe u vendos që për votim, një nga një, të paraqitën amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar 6+ dhe Lista Serbe, të cilat ishin pa përkrahjen e komisionit. Përfaqësuesi i listës serbe, deputeti Igor Simic, tërhoqi amendamentin 12 që ka të bëjë me nenin 8 të Projektligjit ku thuhet, “Në komunat me shumicë serbe ministri do të emërojë noterët të cilët vijnë nga komuniteti serb dhe të cilët i përmbushin kushtet e parapara me ligj”.

Lidhur me propozimin e deputetit Korab Sejdiu që ka të bëjë me nenin 32 paragrafi 1 që ka të bëjë me futjen e gjuhës angleze deputeti Arben Gashi propozoi që të përfshihen edhe gjuhë të tjera në rastet kur noteri merr përgjegjësi personale juridike lidhur me njohjen e saj. Ky propozim u përkrah nga anëtarët e komisionit.

*Pas diskutimeve dhe shqyrtimit të amendamenteve të Grupit Parlamentar 6+ dhe Listës Serbe, Komisioni, me gjashtë vota **për** dhe dy **kundër**, nxori këtë*

Rekomandim:

- I. Miratohet Raporti me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë;
- II. Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë dhe amendamentet e propozuara, procedohen për Shqyrtim, sipas kompetencës në komisionet kryesore;
- III. Amendamentet e miratuara dhe të papërkrahura nga komisioni, janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

5. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim

Nezir Çoçaj, tha se raporti për ndërmjetësim është shqyrtuar nga komisionet e përhershme dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje, por sipas tij, me kërkesë të zyrës të BE-së, grupi punues ka mbajtur edhe një takim, më datë 16.5.2018, nga ku është kërkuar që ky projektligj të kthehet edhe një herë në grup punues, me qëllimin që të rishikohen edhe njëherë komentet e paraqitura nga Zyra e BE-së.

Pas diskutimeve, komisioni, unanimisht, vendosi që Raporti për Projektligjin nr.06/L-009 për Ndërmjetësim të kthehet në grup punues, me qëllim që të rishikohen edhe një herë komentet nga Zyra e BE-së.

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale

Komisioni nuk shqyrtoi Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale, me arsyetimin që është proceduar për seancë plenare, pa miratimin e Komisionit për Legjislacion.

7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Kryetarja, e paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Ajo tha se në raport janë përfshi numra romak dhe arab, disa amendamente i referohen të njëjtës dispozitë dhe konsiderohen si amendamente të ndara, në vend që të jetë një amendament me dy propozime. Po ashtu, amendamentet përmbajnë edhe arsyeime dhe forma tjera që nuk janë praktikë dhe e bëjnë të pamundur vlerësimin nga ana e Komisionit për Legjislacion.

Meqë nuk kishte vërejtje tjera, Kryetarja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

Të hartohet raporti me amendamente në formë standarde, duke përfshirë edhe amendamentet e propozuara nga grupet parlamentare.

8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Draft-Rregulloren e Kuvendit

Hajdar Beqa, njoftoi se grupi punues për Rregulloren e Kuvendit ka shqyrtuar 30 amendamente dhe falënderoi të gjithë ata që kanë dhënë kontribut në harmonizimin dhe përkrahjen e këtyre amendamenteve. Po ashtu, z. Beqa theksoi se Rregullorja ka kaluar në lexim të parë, duke kërkuar nga anëtarët që nëse ka vërejtje teknike, t'i paraqesin ato, në mënyrë që të harmonizohen.

Arben Gashi, potencoi se në koordinim me deputetin Korab Sejdiu dhe Grupin Parlamentar të LDK-së, është bërë një analizë, dhe se përveç amendamenteve, ka edhe disa çështje tjera që duhet sqaruar. Në vazhdim, ai paraqiti vërejtjet e Grupit Parlamentar të LDK-së, me arsyeime, të cilat kishin të bënin me këto nene si vijon: neni 2, konferenca e kryetarëve, neni 20, mbledhjet e Kryesisë, neni 24, neni 28 paragrafi 4, neni 29, neni 40, paragrafi 4, neni 43 paragrafi 2, neni 46, neni 56 paragrafi 11, neni 58, neni 66 paragrafi 5, neni 75 paragrafi 7, neni 85 paragrafi 3 dhe neni 118.

Pas propozimeve për ndryshime nga deputeti, z. Gashi, komisioni, me shumicë votash, vendosi që Raporti me amendamente për Draft-Rregulloren e Kuvendit, të kthehet në grup punues për shqyrtim të mëtutjeshëm.

9. Të ndryshme

Në këtë pikë u vendos që të formohet grupi punues për shqyrtimin e Draft-Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas diskutimeve, komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit punues për Projekt-Kodin Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L- 074.

1. Formohet grupi punues për Projekt-Kodin Penal të Republikës së Kosovës, me këtë përbërje:

- 1) Hajdar Beqa, kryesues
- 2) Albulena Haxhiu, anëtare
- 3) Korab Sejdiu, anëtar
- 4) Arben Gashi, anëtar
- 5) Sami Kurteshi, anëtar
- 6) Bahrim Shabani, anëtar
- 7) Igor Simiq, anëtar.

Në vazhdim, kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit për vizitën që do të ketë delegacioni i Shqipërisë me Komisionin për Legjislacion, më datë 25 dhe 26 qershor. Gjithashtu, komisioni mori vendim që më datë 25.6.2018, të shtrohet drekë zyrtare, për delegacionin nga Shqipëria, deputetët dhe stafin e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:55.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu

Aneks - amendamentet e Projektligjit nr. 06/L-010 per Noterinë

Amendamenti 1

Neni 1 i projektligjit, në rreshtin e katërt, fjalët “**me rëndësi për**”, zëvendësohen me fjalët “**që kanë të bëjnë me**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 2

Neni 2, paragrafi 4 riformulohet si vijon:

“4. Në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, noteri regjistron veprimtarinë e tij si biznes individual në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve.”

Amendamenti 3

Neni 2, nënparagrafi 6.2, në rreshtin e parë, fjala “organet”, zëvendësohet me fjalën “organi” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 4

Neni 2, paragrafi 7, në rreshtin e dytë, numri “70” bëhet “65” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 5

Neni 4, nënparagrafi 2.3 riformulohet si vijon: “2.3 mban pozitë politike;”

Amendamenti 6

Neni 4, nënparagrafi 2.5, hiqet.

Amendamenti 7, dy propozime

A. Komisionit funksional

Neni 6, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

“1. Provimi për Noterinë jepet para Komisionit për Dhënien e Provimit për Noterinë (më tej: Komisioni). Komisionin e emëron ministri, me mandat 3 vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjedhe përbëhet prej kryetarit, katër (4) anëtarë dhe zëvendësit e tyre.”

B. Propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe pa përkrahjen e Komisionit funksional

Është e nevojshme që në nenin 6, paragrafi 1, të shtohet teksti:

“Më së paku 2 anëtarë dhe 2 zëvendësanëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Noterisë publike do të jenë nga komuniteti serb”.

Amendamenti 8

Neni 6, nënparagrafi 1.3, pas fjalës “juridik”, shtohen fjalët: “nga fusha civile;” .

Amendamenti 9

Neni 6, nënparagrafi 1.4 riformulohet si vijon:”1.4. një (1) përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë nga Departamenti Ligjor ose Departamenti për Profesione të Lira.”

Amendamenti 10,propozim i grupit parlamentar 6+ pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 6, pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri, me këtë përmbajtje: “2. njëri nga anëtarët e Komisionit për Dhënien e Provimit të Noterisë duhet të jetë nga radhët e komuniteteve: turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian ose goran”.

Amendamenti 11

Në nenin 7, në rreshtin e gjashtë, pas fjalës”ekonomike”, shtohen fjalët” dhe e drejta e punës;” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 12

Propozim i Grupit parlamentar Lista Serbe pa përkrahjen e Komisionit funksional

Është e nevojshme që në nenin 10, paragrafi 1, të shtohet teksti:

“Konkursi duhet të publikohet në njërin nga mediat e cila emiton program në gjuhën serbe”.

Amendamenti 13 tri propozime

A. Propozim i Komisionit funksional

Neni 10, paragrafi 3 riformulohet si vijon:

“3. Komisioni për zgjedhjen e noterëve emërohet nga ministri, me mandat 3 vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje. Komisioni përbëhet nga kryetari, katër (4) anëtarë dhe zëvendësit e tyre:

3.1 dy (2) noterë të propozuar nga Oda e Noterëve;

3.2 një (1) gjyqtar të propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës;

3.3. një (1) profesor i fakultetit juridik;

3.4 një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë nga radhët e nëpunësve civilë.

B. Propozim i Grupit Parlamentar 6+ pa përkrahjen e Komisionit funksional

Ne nenin 10, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1. pas fjalës “noter”, shtohen fjalët “njëri prej të cilëve duhet të jetë nga radhët e komuniteteve: turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian ose goran.”

C. Propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe pa përkrahjen e Komisionit funksional

Është e nevojshme që në nenin 10, paragrafi 3, të shtohet teksti:

“Më së paku 2 anëtarë dhe 2 zëvendësanëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Noterisë publike do të jenë nga komuniteti serb”.

Amendamenti 14

Neni 10, paragrafi 6 **hiqet** dhe renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 15

Neni 11, paragrafi 5, në rreshtin e katërt, fjalët: “(3) mujor”, zëvendësohen me fjalët: “(6) mujor” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 16

Neni 11, paragrafi 8, në rreshtin e tretë, fjala “arsyeshme” zëvendësohet me fjalën “arsyetuara”.

Amendamenti 17

Neni 11, paragrafi 9, në rreshtin e parë hiqet fjala “e noterëve” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 18

Neni 12, paragrafi 1 riformulohet si vijon: “ 1. Pas dhënies së betimit, noteri është i detyruar të kërkojë nga Oda që t’ia përgatitë vulën rrethore dhe vulën e thatë.”

Amendamenti 19

Neni 12, paragrafi 8 riformulohet si vijon: “8. Nëse vula është gjetur, ajo do të shkatërrohet nga gjykata themelore në territorin ku noteri ushtron veprimtarinë dhe do të ndahet në dy pjesë.”

Amendamenti 20

Neni 16, paragrafi 6 riformulohet si vijon: 6.Me rastin e caktimit të tarifave për noterë, ministri duhet të bëjë një vlerësim paraprak, për të ardhurat për kokë banori dhe ekonominë e vendit.

Amendamenti 21

Neni 17, pas nënparagrafit 2.3, shtohet një nënparagraf i ri 2.4, me përmbajtjen si vijon:

“2.4 Në rastet e shqyrtimit të trashëgimisë, noteri ka konstatuar pas ndjekjes së procedurave të verifikimit të trashëgimtarëve se ka fshehje të trashëgimtarëve ligjorë.”

Amendamenti 22

Neni 17, paragrafi 4 riformulohet si vijon: “4 Kur noteri, me vendim me shkrim, refuzon të përpilojë dokumentin noterial apo të ndër marrë veprimin, pala ka të drejtë ankese brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të aktit të noterit. Sipas ankesës së palës, vendos Oda brenda afatit 15 ditor.”

Amendamenti 23

Neni 18, paragrafi 5, hiqen fjalët: “apo personit të autorizuar” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 24

Neni 19, paragrafi 1, në rreshtin e parë, pas fjalës “palët”, shtohen fjalët “me shkrim” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 25

Neni 19, paragrafi 2, në rreshtin e dytë, fjala “drejtësi”, zëvendësohet me fjalën “drejtshmëri” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 26

Neni 19, paragrafi 3 riformulohet si vijon: “ 3. Nëse palët mbajnë pozicionin e tyre edhe pas dhënies së paralajmërimit të duhur, noteri mund të refuzojë përgatitjen e dokumentit apo që të përfshijë deklaratimet, apo ndryshimet e sugjeruara.”

Amendamenti 27

Neni 20, nënparagrafi 2.1, në rreshtin e dytë, pas fjalës “mësimdhënies”, shtohen fjalët “ jashtë orarit të punës;”

Amendamenti 28

Neni 22, nënparagrafi 1.3, numri “70”, zëvendësohet me “65” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 29

Neni 22, paragrafi 2, në rreshtin e dytë, pas fjalës “përfundimtar”, shtohen fjalët “dhe ndaj tij mund të fillohet konflikt administrativ.”

Amendamenti 30

Neni 26, nënparagrafi 1.4 riformulohet si vijon: “1.4 ndaj tij është caktuar paraburgimi apo arresti shtëpiak, derisa zgjat paraburgimi apo arresti shtëpiak;”

Amendamenti 31

Neni 27, paragrafi 7 riformulohet si vijon: “7. Për dëmin, të cilin u shkakton ushtruesi i detyrës personave të tretë me rastin e ushtrimit të detyrës zyrtare përgjigjet vetë ushtruesi i detyrës së noterit.”

Amendamenti 32

Neni 30, paragrafi 3, në rreshtin e parë, pas fjalës “praktikant”, shtohen fjalët “ me pagesë” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 33

Neni 32, paragrafi 1, në fund të fjalisë, shtohen fjalët: “Dokumentet noteriale mund të lëshohen edhe në gjuhët tjera, në rastet kur noteri merr përgjegjësi personale juridike lidhur me njohjen e saj”.

Amendamenti 34, propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe pa përkrahjen e Komisionit funksional

Është e nevojshme që të ndryshohet neni 32, paragrafi 3, kështu që teksti i ndryshuar të bëhet:

“Të gjitha dokumentet e noterisë publike lëshohen në gjuhën shqipe dhe serbe, si gjuhë zyrtare të barabarta, në përputhje me Kushtetutën, varësisht nga kërkesa e palës”.

Amendamenti 35

Neni 33, paragrafi 1, në rreshtin e pestë, fjalët “e tyre të vërtetë”, zëvendësohen me fjalët “e shprehur të palëve” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 36

Neni 34, nënparagrafi 1.1, në rreshtin e dytë, pas fjalës “deklarata,”, shtohen fjalët “të paqarta” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 37

Neni 35, paragrafi 1 riformulohet si vijon: “1. Noteri që nuk i njeh personalisht palët, identitetin e tyre e vërteton në bazë të letërnjoftimit apo pasaportës, apo me dokument tjetër të identifikimit. Kur kjo nuk është e mundur, identitetin e tyre duhet ta dëshmojnë dy dëshmitarë të identifikuar.”

Amendamenti 38

Neni 35, paragrafi 2, fjalët “ai njuh palët, përkatësisht se në çfarë mënyre”, **hiqen** dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 39

Neni 36, paragrafi 1, në rreshtin e katërt, fjala “(interpreti)”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 40

Neni 37, nënparagrafi 1.1, në rreshtin e dytë, pas fjalës “memeç”, shtohet fjala “verbër” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 41

Neni 38, në titull, pas fjalës “ memeç” shtohet fjala “verbër” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 42

Në nenin 41, pas nënparagrafit 1.2, shtohen dy nënparagrafë të rinj, me përmbajtjen si vijon:

“1.3 Dhënia e pëlqimit nga bashkëshorti për mosregjistrim të pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve, të bëhet me pëlqim të veçantë, jo përmes kontratës, pa kosto financiare”.

“ 1.4. Dhënia e pëlqimit të serishëm, pas një periudhe të caktuar kohore, për të njëjtën pronë, nga bashkëshorti që ka hequr dorë më parë për regjistrimin e pronës së përbashkët, në emër të dy bashkëshortëve, të bëhet pa ndonjë tarifë shtesë financiare, me kusht që kjo procedurë të bëhet për lëndën/pronën e njëjtë, tek i njëjti noter dhe tek i njëjti përfaqësues ligjor i palës ”.

Renditja e nënparagrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 43

Neni 42, nënparagrafi 1.8, hiqet.

Amendamenti 44

Neni 44, nënparagrafi 2.1, fjalët “me pjesëmarrjen e detyrueshme të ekspertit”, hiqen.

Amendamenti 45

Neni 60, paragrafi 3, në rreshtin e tretë, fjala “njoftimin”, zëvendësohet me fjalën “ekstrakt” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 46

Propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe pa përkrahjen e Komisionit funksional

Është e nevojshme që të ndryshohet neni 62 dhe të shtohet në paragrafin 3 pika 6 teksti si vijon:

“Në organet e Odës, të theksuar në nenin 62, paragrafi 3, më së paku 10% e anëtarëve duhet të jenë nga komunitetet jo shumicë: serb, boshnjak, turk, rom, goran, ashkali dhe të tjerë.

Amendamenti 47

Neni 66, paragrafi 1, në rreshtin e parë, fjala”fusë”, zëvendësohet me fjalën “përfshijë” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 48- Propozim i Grupit Parlamentar 6+ pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 67, pas paragrafit 1, shtohet paragraf i ri, me këtë përmbajtje: ”2. njëri nga anëtarët e këshillit të noterëve duhet të jetë nga radhët e komuniteteve: turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian ose goran.”

Amendamenti 49- Propozim i Grupit Parlamentar 6+ pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 68, paragrafi 1 të shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje: ” 2. njëri nga anëtarët e komunitetit të noterëve duhet të jetë nga radhët e komuniteteve: turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian ose goran.”

Amendamenti 50

Neni 69, paragrafi 1 riformulohet si vijon: “ 1. Për zbatimin e procedurës disiplinore formohet komisioni. Komisioni përbëhet nga të paktën pesë (5) anëtarë që zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë deri në tri (3) vite, ku secili anëtar ka zëvendësin e tij. Anëtarët e Këshillit dhe anëtarët e Komitetit nuk mund të jenë edhe anëtarë të komisionit.

Amendamenti 51

Neni 69, paragrafi 2 riformulohet si vijon: “2. Komisioni përbëhet nga noterë që plotësojnë standardet më të larta profesionale, kompetencës dhe integritetit dhe reflekton aspektin gjinor dhe etnik.”

Amendamenti 52

Neni 69, paragrafi 3, në rreshtin e parë, fjala”do të” zëvendësohet me fjalët”duhet të” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 53

Neni 69, pas paragrafit 3 shtohet një paragraf i ri 4 me përmbajtjen si vijon: “4 Anëtar i Komisionit nuk mund të jetë noteri, i cili ushtron veprimtarinë noteriale në të njëjtin territor me noterin ndaj të cilit është filluar procedura disiplinore.”

Paragrafi 4 bëhet 5.

Amendamenti 54

Neni 70, paragrafi 2 në rreshtin e katërt, pas fjalëve “ nënparagrafëve 5.5”, shtohen fjalët “të këtij ligji” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 55, dy propozime

A. Propozim i Komisionit funksional

Neni 72, paragrafi 9 riformulohet si vijon: “9Paneli administrativ për ankesa përbëhet nga pesë (5) anëtarë, përfshirë këtu ministrin apo përfaqësuesin e tij, dy (2) noterë, një (1) profesor nga fakulteti juridik dhe një (1) gjyqtar.

B. Propozim i Grupit Parlamentar 6+ pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 72, paragrafi 9, në fund të fjalisë shtohen fjalët: „ njëri nga anëtarët e panelit duhet të jetë nga radhët e komuniteteve: turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian ose goran.”

Amendamenti 56

Neni 73, paragrafi 1, në fund të paragrafit, pas pikës, shtohen fjalët: “Nuk mund të fillojë procedura disiplinore pas kalimit të afatit 4 vjeçar nga koha kur është kryer shkelja”.

Amendamenti 57

Në nenin 76 të projektligjit, shtohet një paragraf i ri, me përmbajtjen si vijon:

“2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, noterët që kanë mbushur moshën 65 vjeç vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e noterit edhe për dy vite”.

Aneks - amendamentet e Projekt-Kodin nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur;

Amendamenti 1

Në nenin 1 të projektligjit, në rreshtin e nëntë, fjalët “e arsyeshmërisë”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 2

Në nenin 1, pas nënparagrafit 2.3, shtohen dy nënparagrafë të rinj si vijon:

2.4 Direktiva 2016/800 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian, e datës 11 maj 2016, në lidhje me masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë nën dyshim apo të akuzuar në procedurë penale;

2.5 Direktiva 2012/13 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian, e datës 22 maj 2012, në lidhje me të drejtën e informimit për procedurën penale.

Amendamenti 3

Neni 3 i projektligjit, nënparagrafi 1.12, në rreshtin e katërt, pas fjalëve “madhor i ri”, shtohen fjalët “ndjekjen e kryerësve madhorë për veprat e kryera ndaj të miturve” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 4

Neni 3 i projektligjit, nënparagrafi 1.15, pas fjalëve “dënimeve alternative”, shtohen fjalët “si dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.”

Amendamenti 5

Neni 3 i projektligjit, nënparagrafi 1.21, në rreshtin e katërt, fjala” publik”, zëvendësohet me fjalën “policor” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 6

Neni 3 i projektligjit, pas nënparagrafit 1.22, shtohet një paragraf i ri 2, me përmbajtjen si vijon:

“2. Aty ku ka paqartësi rreth moshës së kryerësit të pretenduar, përkitazi nëse ai/ajo është nën apo mbi moshën minimale të përgjegjësisë penale, ai ose ajo do të konsiderohen si nën atë moshë. Aty ku paqartësia vazhdon përkitazi me atë nëse kryerësi i pretenduar është fëmijë apo i rritur, ai apo ajo do të konsiderohet fëmijë.”

Paragrafi 2 i projektligjit, bëhet paragrafi 3.

Amendamenti 7

Neni 4 i projektligjit, paragrafi 9, në rreshtin e parë fjala “Procedure” zëvendësohet me fjalën “Procedura” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 8

Neni 6 i projektligjit, në rreshtin e katërt, pas fjalës “rregulluar”, shtohet fjala “ndryshe” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 9

Neni 9, paragrafi 4 i projektligjit, fjalët “dhe procedura pezullohet”, hiqen.

Amendamenti 10

Neni 10, paragrafi 3 i projektligjit, riformulohet si vijon:

“3. Kur ndërmjetësimi ka sukses me aktvendim hedhet kallëzimi penal dhe prokurori i shtetit për të mitur duhet t’i njoftojë palët lidhur me vendimin e tyre.”

Amendamenti 11

Neni 10, paragrafi 4 i projektligjit, në rreshtin e katërt, fjalët “e miratojnë”, zëvendësohet me fjalët “e miraton” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 12

Neni 11, paragrafi 2 i projektligjit, në rreshtin e dytë, fjala “ i diplomuar”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 13

Neni 12, paragrafi 5 i projektligjit, në rreshtin e tretë, pas fjalëve “dërgimit në” shtohen fjala “institucion” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 14

Neni 14, në titull të nenit, në rreshtin e dytë, hiqet shkronja “i” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 15

Neni 32, pas paragrafit 6, shtohet një paragraf i ri 7, me përmbajtjen si vijon: “ 7.Në raste të tilla, Gjykata nuk është e kushtëzuar nga kohëzgjatja minimale prej një viti për masën e edukimit institucional, e as kohëzgjatja prej gjashtë muaj dënim me burg, të përcaktuara me këtë Kod.”

Amendamenti 16

Neni 42, paragrafi 4 i projektligjit, hiqet.

Amendamenti 17

Neni 42, pas paragrafit 5 të projektligjit, shtohet një paragraf i ri, me përmbajtjen si vijon:

“Avokatët mbrojtës duhet t’i konsiderojnë të miturit si klientë me të drejta të plota, që nënkupton se ata janë të obliguar që të marrin parasysh dhe paraqesin mendimet e tyre, si dhe t’iu sigurojnë atyre të gjitha informatat dhe sqarimet e nevojshme në lidhje me pasojat e mundshme të pikëpamjeve dhe mendimeve të tyre.”

Amendamenti 18

Neni 37 i projektligjit, hiqet dhe renditja e neneve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 19

Titulli i nenit 45, riformulohet si vijon: “ **Veçimi dhe bashkimi i procedurës**”

Amendamenti 20

Neni 46, në rreshtin e pestë, pas fjalës “procedurës”, shtohet fjala “mund” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 21

Neni 46, paragrafi 2, në rreshtin e katërt, fjala “kundër”, zëvendësohet me fjalën “ndaj” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 22

Neni 52, paragrafi 1, në rreshtin e katërt, fjala “kundër”, zëvendësohet me fjalën “ndaj” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 23

Neni 53, paragrafi 2, në rreshtin e tetë, fjala “ kundër”, zëvendësohet me fjalën “ndaj” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 24

Neni 57, nënparagrafi 1.3, fjala “falje”, zëvendësohet me fjalën “amnisti”.

Amendamenti 25

Neni 58, paragrafi 3, në rreshtin e katërt, fjala “një”, zëvendësohet me numër “1” “ndaj” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 26

Neni 62, paragrafi 2, në rreshtin e nëntë, fjala “shtetë”, zëvendësohet me fjalën “shtesë”, kurse fjalët “*Paraburgimi mund të vazhdohet vetëm nga kolegji për të mitur.*”,**hiqen.**

Amendamenti 27

Neni 63, paragrafi 3, në rreshtin e dytë, fjalët “sipas nevojës dhe”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 28

Neni 64, në titull, në rreshtin e dytë, hiqet fjala “si”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 29

Neni 65, paragrafi 1, në rreshtin e nëntë, fjala “ jo oportune”, zëvendësohet me fjalën “të arsyeshme” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 30

Neni 64, paragrafi 2, në rreshtin e dytë, fjala “miture”, zëvendësohet me fjalën “mitur” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 31

Neni 84, titulli riformulohet si vijon: “**Pezullimi i ekzekutimit të masës edukative institucionale**”.

Amendamenti 32

Në nenin 90, pas paragrafi 2, shtohet një paragraf i ri 3, me përmbajtjen si vijon:

“4. I mituri ka të drejtë në pushim vjetor prej 30 ditësh, të cilin me leje të drejtorit të Institucionit mund ta shfrytëzojë edhe jashtë lokaleve të institucionit.”

Paragrafi 3 bëhet 4.

Amendamenti 33

Neni 93, paragrafi 2, në rreshtin e parë, fjalët “grykëta e viziton të miturit”, zëvendësohen me fjalët “gryqtari për të mitur viziton të miturit”.

Amendamenti 34

Neni 102, paragrafi 1 riformulohet si vijon: "1. Si rregull, të miturit i mbajnë dënimet e tyre në ambiente të përbashkëta me të miturit e tjerë të dënuar".

Amendamenti 35

Neni 102, paragrafi 2, në fund të paragrafit, pas pikës, shtohen fjalët “Kërkesa e të miturit që të ndahet nga personat e tjerë duhet të parashtrohet në formë të shkruar.”

Amendamenti 36

Neni 109, në paragrafin 1, në të gjithë nënparagrafët, hiqen kllapat me referencat e neneve.

Amendamenti 37

Neni 109, pas nënparagrafit 1.35, shtohet një nënparagraf i ri 1.36, me përmbajtjen si vijon:

“1.36 Martesa e Detyruar”

Amendamenti 38

Neni 113, paragrafi 4, në rreshtin e dytë, pas fjalës “penale”, shtohen fjalët “sipas nenit 109 të këtij kodi” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 39

Neni 113, nënparagrafi 4.1, në rreshtin e katërt, hiqen fjalët “dhe me prezencën e zyrtarit policor” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 40

Neni 114, riformulohet si vijon:” Nëse gjatë procedurës penale vërtetohet se prindi i keqpërdor apo i lë pas dore detyrat prindërore dhe të drejtat, ose po i shkel të drejtat e fëmijës, prokurori e informon organin e kujdestarisë për procedurën jashtëkontestimore për heqjen e të drejtave për përkujdesje prindërore nga prindi.”

Në rreshtin e katërt, pas fjalës “prokurori”, shtohen fjalët “” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 41

Neni 124, paragrafi 1, në rreshtin e nëntë, fjala “kampioni”, zëvendësohet me fjalën “mostër” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 42

Neni 126, në titull, fjala “Rolet e”, zëvendësohet me fjalët “Roli i” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 43

Në nenet 137, 138, 139 dhe 141, fjalët “fillimi zbatimit”, zëvendësohen me fjalët “hyrja në fuqi”, sipas kontekstit të fjalisë.